



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:032539

Datë: 29.12.2023

Numri i dokumentit: 05142173

C-III. - 12- 1619

Paditës: B N, nga fshati T J, Ferizaj

Kundër

Të paditurive: 1) NSH “IMK Fabrika për prodhimin e Tubave”, të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, në Prishtinë, rr. „Driton Hoxha ” 55.
2) Komuna e Ferizajit, në Ferizaj

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Manushe Karaçi gjyqtare kryesuese, Shkelzen Sylaj dhe Sylejman Shumolli, gjyqtarë, pas seancës dëgjimore publike të datës 20 dhjetor 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M
PËR MOSPARAQITJE**

- I. HEDHET poshtë padia e paditësit B N nga fshati T i J për shkak të mos paraqitjes në seancë dëgjimore.**
- II. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Më 21 shtator 2012, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, nga Gjykata Komunale në Ferizaj, ka pranuar lëndën, C.nr/443/06 të datës 17 shtator 2012, pas plotfuqishmërisë së aktvendimit, në kompetencë të mëtutjeshme.

Më 7 gusht 2006, Gjykata komunale ne Ferizaj ka pranuar padinë e parashtruar nga paditësi R N, pasardhës, B N kundër të paditurit NSH “ T J” dhe Komunës së Ferizajt për vërtetimin e

pronësisë.

Paditësi ka theksuar se është pronar dhe posedues ligjor i pasurisë së paluajtshme në fshatin T të J, komuna e Ferizajt dhe atë në ngastrën kadastrale me kulture arë, klasa e tretë në sipërfaqe prej 00,28,67, e cila pasuri gjendet e evidentuar në fletë posedimin, nr. ..K.K J T. Më tutje, paditësi ka deklaruar se është bërë ekspropriimi dhe kjo pasuri është bartur në pronë shoqërore në dobi të komunës së Ferizajt, e për nevojat e organizatës punuese IMK Fabrika për prodhimin e tubave.

Kësisoj, parashtruesi i padisë kërkoi nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme që të miratojë padinë dhe kërkesat e saj, ashtu që të vërtetohet se paditësi është i vetmi pronar legjitim në ngastrën kadastrale, nr.... me kulture arë, klasa e tretë, në sipërfaqe prej 00.28.67 si dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia pranojë të drejtën e pronësisë dhe t'ia lejojë regjistrimin e të njëjtës në librat gjegjëse të Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi në Ferizaj në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit.

Në mbështetje të pretendimeve të padisë parashtruesit për gjykatën kanë dorëzuar:

- *Kopjen e fletës poseduese nr. „J T në emër të të ndjerit R N;*
- *Kopjen e Aktvendimit të Kuvendit Komunal në Ferizaj nr. 03-465-5 të datës 26 prill 1982;*
- *Konkluzionin mbi ekzekutimin 03-465-5 të datës 14 maj 1982;*

Më 8 gusht 2012, Gjykata Komunale në Ferizaj ka nxjerrë Aktvendimin C.nr.443/06 me të cilin është shpallë jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vepruar në këtë çështje juridike. Pas plotfuqishmërisë së aktvendimit padia dhe shkresat e lëndës iu janë përcjellë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në kompetencë të mëtejme.

Më 25 korrik 2019, e paditura, AKP-ja dorëzoi mbrojtjen e vet me të cilën kërkoi nga gjykata që kërkesa e paditësit R N, pasardhës i B N për vërtetim të pronësisë dhe kthimin në posedim, të refuzohet si e pa bazuar në ligj.

Më 2 gusht 2019, paditësi me anë të një parashtrëse ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në kuptimin subjektiv, me anë të së cilës ka njoftuar gjykatën se paditës është B N nga fshati T J, komuna e Ferizajt.

Më 2 gusht 2019, e paditura, Komuna e Ferizajt ka dorëzuar mbrojtjen e vet me të cilën ka kërkuar nga gjykata që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar. Po ashtu, për Gjykatën ka dorëzuar shkresën, nr. 86444/19 të datës 25 korrik 2019 e DHPGJK-së si dhe Certifikatën e datës 25 korrik 2019.

Më 29 gusht 2019, e paditura, AKP-ja me anë të një parashtrëse ka bërë plotësimin e mbrojtjes, me anë të së cilës për gjykatën ka dorëzuar :

- *Kopjen e kërkesës për lëshim të Historikut dhe shkresave të lëndës për parcelën kadastrale nr. ...ZK. T J të datës 25 korrik 2019;*
- *Përgjijen e Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi në Kuvendin Komunal në Ferizajit e datës 7 gusht 2019;*
- *Kopjen e fletëposedimit nga KCID Fillestar nr. ...e datës....;*
- *Kopjen e Draft Certifikatën e Pronës për njësinë Kadastrale P-7.....ZK. T J në Ferizaj e dt.....*

Më 23 mars 2023, paditësi ka paguar taksës gjyqësore në shumë prej 100 euro si dhe në përgjigje të urdhrin të Gjykatës ka dorëzuar Aktvendimin e Trashëgimisë T.nr.159/05 të dt. 13 korrik 2005 i Gjykatës Komunale të Ferizajt si dhe me Aktvendimin e Trashëgimisë LRP. NR.dhe REF, nr.e dt.lëshuar nga Shërbimi Noterial në Ferizaj, me të cilin si trashëgimtare e rendit të parë të trashëgimisë shpallet Arixhe A N, bashkëshortja e trashëgimlënësit si trashëgimtare e rendit të parë.

Më 18 prill 2023, AKP-ja është përgjigjur në urdhrin e gjykatës së datës 14 prill 2023 për përgjigje në parashtrësën e paditësit për rregullimin subjektiv të padisë. Me anë të kësaj përgjigje, AKP-ja e ka kundërshtuar në tërësi parashtrësën për rregullimin subjektiv të padisë për shkak se paditësi nuk ka bashkangjitur asnjërin nga vendimet me të cilat është rregulluar trashëgimia dhe me të cilat vërtetohet legjitimiteti aktiv i palës.

Më tej, AKP-ja e ka njoftuar gjykatën se ngastra kontestuese me numër 120-0 ZK T J është bashkuar me parcelat tjera dhe kanë marrë numrin..., të bartur në emër të E sh.p.k, Qirambajtje për 99 vjet, me anë të Kontratës, nr. ...të dt..... Andaj, përfaqësuesi i AKP-së, i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Fillimisht, me dt. 29 nëntor 2023, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ua ka dorëzuar njoftimin palëve ndërgjyqës për mbajtjen e seancës dëgjimore, për dt. 19 dhjetor.2023, të cilin njoftim e ka pranuar, më dt. 01 dhjetor 2023, paditësi, B N dhe të paditurat, Komuna e Ferizajt dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Ndërsa, me datën 4 dhjetor 2023, Gjykata ka njoftuar palët ndërgjyqëse se për shkak të një gabimi teknik në ftesën paraprake, seanca dëgjimore do të mbahet me datën 20 dhjetor 2023, të cilin njoftim e kanë pranuar të paditurat, Komuna e Ferizajt dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërsa pala paditëse e ka refuzuar ftesën dy herë radhazi.

Në seancë dëgjimore, të mbajtur me dt. 20.12.2023, nuk ka prezantuar paditësi, ndërsa ka prezantuar përfaqësuesja e AKP-së dhe përfaqësuesi i Komunës së Ferizajt të cilët kanë kërkuar të merret aktgjykim për mosparaqitje.

Arsyetimi Ligjor

Padia e paditësit hedhet.

Me nenin 58 të Ligjit nr. 06/L-086, është paraparë „ 1. Nëse pala kundërshtare, të cilës i është dorëzuar kërkesa, nuk paraqitet në seancë dëgjimore për të cilën është njoftuar sipas rregullit dhe me kohë, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës, sipas detyrës zyrtare, apo në bazë të kërkesës së Parashtruesit, mund të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër palës kundërshtare.

2. Nëse parashtrues i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës mund, pas parashtrimit të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, paditësi ishte ftuar në mënyrë të rregullt, pasi që njoftimi i është dorëzuar me kohë, dhe paditësi e kishte refuzuar. Njoftimi për mbajtjen e seancës dëgjimore publike të caktuar për dt.20.12.2023 dhe për pasojën juridike nëse nuk prezanton në seancë dëgjimore, në lidhje me zbatimin e nenit 58 të Ligjit nr. 06/L-086 i është ridërguar edhe njëherë palës paditëse, dhe i njëjti është refuzuar.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret janë përmbushur të gjitha kriteret e parapara për marrjen e Aktgjykimit për mosparaqitje sipas nenit 58, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 2, të Ligjit, nr. 06/L-086, pasi paditësi është ftuar në mënyrë të rregullt për mbajtje të seancës dëgjimore për dt. 20.12.2023, në ora 13:30, ndërsa nuk ka prezantuar.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme , u vendos që secila palë ti heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi, sipas nenit 59, të Ligjit nr. 06/L-086, mund të ushtrohet kërkesë për prishje të aktgjykimit për mosparaqitje në afatin prej një muaj dite, Kërkesa i dorëzohet Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe palës kundërshtare / të paditur.

Manushe Karaçi, Gjyqtare kryesuese

Shkëlzen Sylaj, Gjyqtar

Sylejman Shumolli, Gjyqtar